



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR.05/2024 EDUKIMI PËR
MBROJTJEN E FËMIJËS¹**

¹ Udhëzimi Administrativ (QRK) - Nr. 05/2024 Edukimi për Mbrojtjen e Fëmijës, miratuar në Mbledhjen e 214-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 03/214 të datës 24.07.2024.

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 63 të Ligjit nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës (GZ, nr. 14.e dt. 17.07.2019), nenit 4, nënparagrafit 4.5 të paragrafit 4 të nenit 8 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (G. z. e Republikës së Kosovës / nr. 34 / 18 nëntor 2022, Prishtinë),

Miraton:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV
(QRK) NR.05//2024
EDUKIMI PËR MBROJTJEN E FËMIJËS**

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është përcaktimi i roleve, organizimit, funksionimit, bashkëpunimit, detyrave dhe përgjegjësiwe për të gjitha institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese në edukimin për mbrojtjen e fëmijës.

**Neni 2
Fushëveprimi**

1. Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ janë të detyrueshme për të gjitha institucionet edukativo- arsimore dhe aftësuese, të cilat punojnë me fëmijë deri në moshën 18 vjeç si dhe përgatisin kuadro për punën me fëmijë.
2. Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ zbatohen për të gjitha institucionet edukative, arsimore dhe aftësuese, fëmijës, prindit, kujdestarit ligjor si dhe palët tjera të interesit që janë subjekt për mbrojtjen e fëmijës.

**Neni 3
Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këto kuptime dhe duhet të interpretohen dhe lexohen konform kuptimit të dhënë në Ligjin për mbrojtjen e fëmijës.

Neni 4

Parimet e përgjithshme për të drejtat e fëmijës

Për të gjitha veprimet dhe vendimet që ndërmarrin institucionet për të drejtat e fëmijës, autoritetet udhëhiqen nga parimet e proklamuar nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës, të cilat janë të inkuorporuara në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës.

II. ROLI I MEKANIZMAVE INSTITUCIONALE

Neni 5

Roli i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

1. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, karshi edukimit për mbrojtje të fëmijës, ka obligime në disa drejtime:

1.1. Harton politikë në funksion të mbrojtjen e fëmijës në kontekst të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese, në përputhje me ligjin në fuqi, me qëllim të parandalimit të çdo forme të dhunës, diskriminimit, trafikimit, punës së rrezikshme dhe dukurive tjera negative që e sfidojnë pjesëmarrjen e fëmijës në arsim dhe zhvillimin e plotë;

1.2. Harton dhe krijon programe për edukimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me pasojat degraduese të ndëshkimit trupor si dhe programe prindërimi, që promovojnë mënyrat jo të dhunshme të disiplinimit në familje, institucione edukativo - arsimore dhe aftësuese si dhe në institucione të kujdesit;

1.3. Monitoron përmes inspektoratit zbatimin e politikave të mbrojtjes së fëmijës brenda institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese;

1.4. Bashkëpunon me institucionet përkatëse dhe mbështet iniciativa të nivelit ndërkombëtar, rajonal, qendror e lokal për zbatimin e politikave për edukimin në mbrojtjen e fëmijës;

1.5. Përkrah zhvillimin dhe zbatimin e programeve për zhvillim profesional të edukatorëve dhe mësimdhënësve lidhur me edukimin në mbrojtjen e fëmijës;

1.6. Fuqizon sistemin e parandalimit, identifikimit, referimit, raportimit, dhe të reagimit ndaj të gjitha formave të dhunës e të abuzimit;

1.7. Orienton mjetet mësimore dhe kurrikulat shkollore në të gjitha institucionet përkatëse edukativo-arsimore dhe aftësuese në mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijës.

Neni 6
Obligimet e Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA-ve)

1. Drejtoria Komunale e Arsimit (më tutje DKA) ka detyrat si në vijim:
 - 1.1. Mbikëqyr dhe siguron që të gjitha institucionet edukativo-arsimore, i kanë hartuar dhe zbatojnë politikat për mbrojtjen fëmijës;
 - 1.2. Inicion dhe zbaton aktivitete ndërgjegjësuese për edukimin në mbrojtjen e fëmijës në nivel të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese;
 - 1.3. Ndërmerr aktivitete ndërgjegjësuese për edukimin për mbrojtjen e fëmijëve, edukimin shëndetësor, veprimet në raste emergjente, të fatkeqësive natyrore dhe rreziqeve tjera që kanosin jetën e fëmijës;
 - 1.4. Ndërmerr veprime ndërgjegjësuese për zbatimin e masave të sigurisë në aktivitetet brenda dhe jashtë institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues;
 - 1.5. Bashkëpunon dhe përkrah aktivitetet e partnerëve qeveritarë, joqeveritarë dhe të grupeve tjera të interesit për avancimin e edukimit për mbrojtjen e fëmijës;
 - 1.6. Siguron mundësi të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve dhe edukatorëve në shërbim, për politikat e mbrojtjes së fëmijës;
 - 1.7. Siguron kapacitete të mjaftueshme për mbikëqyrje dhe raportim, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 7
Obligimet e institucionit edukativ dhe arsimor

1. Institucioni edukativ dhe arsimor siguron që edukimi për mbrojtjen e fëmijës të jetë prioritet në të gjitha politikat brenda institucionit, si në :
 - 1.1. Rregulloren e shkollës dhe aktet tjera të brendshme;
 - 1.2. Planin zhvillimor të shkollës/ institucionit edukativ, arsimor dhe aftësues;
 - 1.3. Aktivitetet kurrikulare, ndërkurrikulare dhe ekstrakurrikulare.
2. Organet e shkollës dhe i gjithë personeli arsimor dhe mbështetës marrin pjesë aktive në parandalimin dhe raportimin e të gjitha formave të dhunës, diskriminimit, trafikimit, punës së rrezikshme dhe dukurive tjera negative, të rrezikshme për fëmijë.
3. Staf i profesional dhe mbështetës: psikologu, pedagogu, logopedi, punëtori social etj., bashkëpunojnë në ndërgjegjësimin e stafit arsimor për parandalimin dhe raportimin e të gjitha

formave të dhunës, diskriminimit, trafikimit, punës së rrezikshme dhe dukurive tjera negative që e dëmtojnë zhvillimin e fëmijëve në institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese.

4. Institucioni edukativo-arsimor dhe aftësues bashkëpunon me partnerë qeveritarë, joqeveritarë, prindër, edukatorë dhe mësues dhe grupe të tjera të interesit për edukimin më të mirë në mbrojtjen e fëmijëve.

5. Mban sesione informuese dhe trajnime me bazë në shkollë për edukimin për mbrojtjen e fëmijëve, edukimin shëndetësor, veprimet në raste emergjente, të fatkeqësive natyrore dhe rreziqeve tjera që kanosin sigurinë dhe jetën e fëmijës.

6. Ndërmerr veprime ndërgjegjësuëse për zbatimin e masave të sigurisë në aktivitetet brenda dhe jashtë institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues (përfshirë ekskursionet).

7. Raporton në baza të rregullta shqetësimet dhe rastet e të gjitha formave të dhunës, diskriminimit, trafikimit, punës së rrezikshme dhe dukurive tjera që paraqesin rrezik apo kanosje për fëmijë.

Neni 8

Obligimet e drejtorit të institucionit edukativo- arsimor dhe aftësues

1. Drejtori i institucionit edukativo- arsimor dhe aftësues ka këto detyra:

1.1. Mbikëqyr dhe udhëheq zbatimin e politikave për mbrojtjen e fëmijës nga ana e edukatorëve, mësuesve dhe gjithë stafit profesional, administrativ, teknik e mbështetës;

1.2. Bashkëpunon me edukatorët, mësuesit dhe gjithë stafin tjetër profesional dhe teknik për identifikimin e nevojave dhe ndërmarrjen e veprimeve në parandalimin e të gjitha llojeve të dhunës, diskriminimit, trafikimit, punës së rrezikshme dhe dukurive tjera negative që pengojnë zhvillimin e fëmijës;

1.3. Koordinohet me nivelin e DKA-së dhe me partnerë të tjerë qeveritarë dhe joqeveritarë për të ofruar edukimin më të mirë për mbrojtjen e fëmijës;

1.4. Mbikëqyrë dhe siguron identifikimin, raportimin dhe referimin e të gjitha llojeve të dhunës, diskriminimit, trafikimit, punës së rrezikshme dhe dukurive tjera negative, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

1.5. Identifikon nevojat e stafit për zhvillim profesional në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe siguron përmbushjen e tyre;

1.6. Zhvillon mekanizma efikas të komunikimit dhe bashkëveprimit me prindër, duke motivuar përgjegjësinë prindërore në interesin më të mirë të fëmijës.

Neni 9

Obligimet e edukatorëve dhe mësimeve

1. Edukatorët dhe mësimeve kanë për obligim:

1.1. Zbatimin efikas të aktiviteteve kurrikulare, ndërkurrikulare dhe ekstakurrikulare në lidhje me edukimin për mbrojtjen e fëmijës, përfshirë edhe bashkëpunimin me ekspertë të jashtëm (si punëtori social, sociologu, mjeku, polici, etj);

1.2. Ndërgjegjësimin për raportimin e të gjitha llojeve të dhunës, keqtrajtimit neglizhimit, diskriminimit, trafikimit, punës së rrezikshme dhe dukurive tjera negative, sipas legjislacionit në fuqi;

1.3. Bashkëpunimin me shërbimet tjera profesionale për edukimin mbi, identifikimin dhe trajtimin e fëmijës viktime të dhunës, keqtrajtimit, neglizhimit, trafikimit, të përfshirjes në punë të rrezikshme apo në dukuri tjera negative;

1.4. Bashkëpunimin me të gjitha grupet e interesit (menaxhmentin e shkollës, organet e shkollës, aktivet profesionale, Këshillin e prindërve, Këshillin e nxënësve, prindër, nxënës dhe komunitetin e gjerë) në ndërgjegjësimin për mbrojtjen e fëmijëve si dhe parandalimin e dukurive negative që cenojnë edukimin dhe zhvillimin e fëmijës.

Neni 10

Roli i Këshillit drejtues

Këshilli drejtues i shkollës, shqyrton, mbështet, aprovon dhe e mbikëqyr realizimin e aktiviteteve për edukimin në mbrojtje të fëmijës.

Neni 11

Roli i Këshillit të prindërve

1. Këshilli i prindërve (më tutje KP) bashkëpunon me udhëheqjen e shkollës, organet, stafin dhe komunitetin e gjerë për iniciativat dhe aktivitetet e edukimit për mbrojtjen e fëmijës, nxënësit, gjithnjë bazuar në programet më të mira të prindërimit.

2. KP përfaqëson interesin më të mirë të fëmijës, adreson shqetësimet për shkeljet, veprimet e dhunshme dhe të dëmshme për fëmijë, si dhe kërkon përgjegjësinë institucionale.

3. Prindërit përmes KP ndërgjegjësohen për zbatimin e politikave për mbrojtjen e fëmijës.

Neni 12

Roli i Këshillit të nxënësve

1. Këshilli i nxënësve (më tutje KN) përfaqëson interesin, të drejtat e fëmijës/ nxënësit dhe bashkëpunon me udhëheqjen e shkollës, organet, stafin, prindërit dhe komunitetin e gjerë për organizimin dhe pjesëmarrjen në aktivitetet ndërgjegjësuese për edukimin në mbrojtjen e fëmijës.

2. KN adreson shqetësimet për shkeljet, veprimet e dhunshme dhe të dëmshme për fëmijë, si dhe kërkon përgjegjësinë institucionale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 13

Roli i stafit profesional mbështetës

1. Stafi profesional - mbështetës, si brenda ashtu edhe jashtë shkollës: psikologu shkollor, pedagogu, mjeku, logopedi dhe stafi tjetër i angazhuar, zhvillon dhe zbaton programe ndërgjegjësuese për edukatorët mësimdhënësit, prindërit dhe stafin administrativ e teknik në lidhje me edukimin për mbrojtjen e fëmijës.

2. Stafi profesional - mbështetës sipas paragrafit 1 të këtij neni, punon ngushtë me fëmijë/ nxënës rreth aspekteve të mbrojtjes së fëmijëve nga rrethanat e dëmshme për zhvillimin e tyre fizik, intelektual, social, emocional dhe të gjithmbarshëm.

3. Stafi mbështetës, mbështet fëmijën që është në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje.

Neni 14

Edukimi për mbrojtjen e fëmijës në media

1. Institucioni edukativo arsimor dhe aftësues promovon edukimin medial përmes zbatimit efikas të kurrikulës arsimore, në veçanti:

1.1. Edukimin për sa i përket të kuptuarit dhe përdorimit të mediave si dhe edukimin për mbrojtje nga përmbajtjet e dëmshme mediale;

1.2. Zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive të stafit të institucioneve edukativo arsimore lidhur me mediat dhe ndërlidhjen e tyre me mbrojtjen e fëmijëve;

1.3. Organizimin e aktiviteteve edukative dhe parandaluese me fëmijë dhe prindër lidhur me edukimin për media në bashkëpunim me palët tjera të interesit.

2. Institucioni edukativo – arsimor dhe aftësues nuk e ekspozon fëmijën në fotografi, video, rrjete sociale apo në aktivitete mediale pa lejen e prindit apo kujdestarit ligjor.

3. Institucioni edukativo-arsimor dhe aftësues, sigurohet që janë marrë të gjitha masat për mbrojtjen e fëmijës, kur merr pjesë në media në kuadër të aktiviteteve shkollore, përfshirë dhe parandalimin e keqpërdorimit për qëllime komerciale.

4. Institucioni edukativo- arsimor dhe aftësues sigurohet që fëmijët janë të mbrojtur përmes programeve të edukimit, gjatë tërë kohës sa janë duke shfrytëzuar/lundruar në internet dhe format tjera të komunikimit.

Neni 15
Edukimi për mbrojtjen e fëmijës nëpërmjet arsimit të lartë

1. Të gjitha njësitë akademike që përgatisin kuadro për punën me fëmijë, të integrojnë politikat e mbrojtjes së fëmijës në kurrikulat e tyre arsimore dhe praktikën e studentëve përgjatë viteve të studimit.
2. Të gjitha njësitë akademike që përgatisin kuadro për punën me fëmijë, zhvillojnë kapacitetet e studentëve dhe profesionistëve për të identifikuar, referuar, raportuar dhe hetuar rastet e fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje nga çdo formë e dhunës;
3. Fakultetet e Edukimit zhvillojnë dhe zbatojnë programet e akredituara për zhvillimin profesional për edukatorë, mësimdhënës dhe staf mbështetës në shërbim për mbrojtjen e fëmijës dhe për sistemin e raportimit dhe referimit me qasje ndërsektoriale.

III. BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI

Neni 16
Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstytucional

1. Stafi i institucionit edukativo- arsimor dhe aftësues bashkëpunon me shërbimet tjera të mirëqenies sociale, shëndetësisë, sigurisë dhe shërbime të tjera të nevojshme për realizimin e aktiviteteve edukuese për mbrojtjen e fëmijës, përfshirë ndërgjegjësimin për raportim dhe trajtim me qasje ndërsektoriale.
2. Në të gjitha nivelet institucionale bëhet koordinim e bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe agjencionet vendore dhe ndërkombëtare, në funksion të edukimit për mbrojtjen e fëmijës.

Neni 17
Konfidencialiteti

1. I gjithë stafi dhe komuniteti i institucioneve edukativo- arsimore dhe aftësuese respektojnë konfidencialitetin e të dhënave të fëmijës në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Stafi i institucioneve edukativo- arsimore dhe aftësuese edukohet për ruajtjen e konfidencialitetit të rasteve që trajtohen brenda institucioneve edukative dhe arsimore apo në nivel të tryezës multidisiplinare, në pajtim me dispozitat përkatëse, me përjashtim të rasteve kur për arsye ligjore duhet të bëhet zbulimi pranë organeve kompetente.
3. Dispozitat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale zbatohen për mënyrën e mbledhjes së të dhënave, përpunimit, ruajtjen dhe përdorimin e të dhënave.

IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 18 Mbikëqyrja dhe llogaridhënia

1. Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij Udhëzimi administrativ e bëjnë komunat, inspektorati i arsimit dhe Zyra e Kryeministrit.
2. Shkeljet e dispozitave të këtij Udhëzimi Administrativ dhe abuzimi me të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen e tyre, dënohen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 19 Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës

02.Gusht.2024